



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2021

V E N D I M

Nr. 99, Datë 07/06/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 94, datë 24.05.2021, e znj. D.Ll., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*” dhe “*gjendjes arsimore*”, nga ana e Bashkisë Lezhë.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri¹,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se ankuesja është diplomuar pranë Universitetit Bujqësor Tiranë, në vitin 1995. Nëpërmjet Vendimit nr. 1, datë 10.07.2012, të Kryetarit të Komunës Blisht-Lezhë, znj. D.Ll është emëruar punonjëse në Zyrën e Gjendjes Civile Blinisht, Lezhë. Ankuesja është punësuar në këtë pozicion pune, nëpërmjet konkurimit të kryer pranë Ministrisë së Brendshme, në zbatim të Urdhërit nr. 1366, datë 10.08.2006 të Ministrit të Brendshëm, “*Për miratimin e rregullores për pranimin në detyrë të punonjësit të zyrës së gjendjes civile*”.²

Znj. D.Ll sqaron se në kushtet, kur bashkëshorti i saj jetonte në Gjermani, si dhe për arsye të gjendjes shëndetësore jo të mirë, të shkaktuar si pasojë e marrëdhënies së punës tepër stresuese

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

² Referuar shkresës nr. 2446/6, datë 05.07.2012, së Ministrisë së Brendshme;

nga presioni politik që ushtrohej mbi të, ka marrë 1 muaj leje³ dhe në shtator 2015 ka lëvizur për në Gjermani. Znj. D.LI pretendon se në momentin e mbërritjes në këtë vend i është vjedhur çanta e dorës, ku ndodhej edhe pasaporta e saj. Për këtë fakt, ajo ka njoftuar punëdhënësin e saj, Ambasadën e Republikës së Shqipërisë në Gjermani, si dhe ish-Ministrin e Brendshëm, pasi nuk mund të kthehej në detyrë në datën e caktuar. D.LI shprehet se ka jetuar në Gjermani për 2 vjet e 8 muaj, pasi ka bërë edhe një gjyq për të siguruar azil politik në këtë vend dhe në vijim kur është konsideruar se situata në Shqipëri ka qenë më e sigurtë, është rikthyer në datën 08.03.2018. Ankuesja pretendon se shteti gjerman e ka pajisur me një dokument leje kalimi për t'u kthyer në Shqipëri.

Pas rikthimit në Shqipëri, znj. D.LI shprehet se i ka kërkuar z. F. F., ish-Kryetar i Bashkisë Lezhë, për t'u rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës, por ky nuk ka pranuar me arsyetimin, se ai pozicion pune tashmë ishte i zënë. Në vijim, ankuesja i ka kërkuar të punësohet në Zyrën e Gjendjes Civile Balldre, e cila sipas ankuses kishte qendruar për shumë kohë e mbyllur, pasi nuk kishte patur një punonjës permanent, si dhe ish-punonjësja P.P. kishte dalë në pension pleqërie. Por, edhe ky punësim nuk është bërë i mundur. Në vijim, ankuesja i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, në Tiranë, për t'u rikthyer në pozicionin e mëparshëm të punës, pranë Zyrës së Gjendjes Civile Blinisht, por një gjë e tillë nuk realizuar. Ajo pretendon gjithashtu se gjatë periudhës që ka qenë jashtë shtetit, pagat për pozicionin e saj të punës janë dhënë duke shfrytëzuar emrin e saj dhe ajo nuk ka dijeni ku kanë përfunduar. Njëkohësisht, ankuesja D.LI pretendon gjithashtu se dosja e saj e emërimit në pozicionin e punës, që ajo ka mbajtur pranë Zyrës së Gjendjes Civile Blinisht, Lezhë, është fshehur qëllimisht nga Bashkia Lezhë. Nëpërmjet Vendimit nr. 641, datë 26.11.2018, të ish-Kryetarit të Bashkisë Lezhë, znj. D.LI është komanduar në detyrën e specialistes së Shërbimit Veterinar dhe Kontrollit Ushqimor, në Njësinë Administrative Bilisht në Bashkinë e Lezhës dhe pavarësisht mospasjes së një kontrate formale pune, në bazë të nenit 21/4 të Kodit të Punës, kjo kontratë pune është konsideruar se ka ekzistuar dhe ka qenë pa afat të caktuar.

Me Urdhërin nr. 78, datë 28.02.2019, e Kryetarit të Bashkisë Lezhë, mbështetur në propozimin e Administratorit të Njësisë Administrative Blinisht, ankuesja ka kaluar në pozicionin e specialistes së Bujqësisë dhe A.T.M., deri në hapjen e procedurave të konkurimit për shërbimin civil. Ky pozicion pune, në referencë të legjislacionit për shërbimin civil ishte pjesë e shërbimit civil dhe në këtë pozicion ankuesja është emëruar me vendim të titullarit të Bashkisë Lezhë, pa u zbatuar procedura e konkurimit, sipas dispozitave përkatëse ligjore.

Në vitin 2019, Komisioni për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil ka ushtruar kontroll në Bashkinë e Lezhës për zbatimin e ligjshmërisë në plotësimin e pozicioneve të punës, që ishin pjesë e

³ Referuar kërkesës së datës 16.09.2015, të znj. D.LI drejtuar z. Fran Frroku, Kryetar i Bashkisë Lezhë, z. Z.Gj., përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile, Lezhë, dhe z. S.L. Administrator i Njësisë Administrative Blinisht.

shërbimit civil. Në përfundim të verifikimit të kryer, me anë të Vendimit nr. 93, datë 15.10.2019, KMSHC ka konstatuar 143 rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil në Bashkinë Lezhë dhe një nga këto emërime ishte edhe rasti i znj. D.Ll. Në zbatim të detyrës së lënë nga KMSHC, Bashkia Lezhë ka kryer procedurat për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, duke ndërprerë marrëdhëniet e punës me punonjësit e emëruar në kundërshtim me ligjin. Në këtë kuadër, ky institucion ka zbatuar procedurat ligjore për lirim të ankueses nga detyra.

Ankuesja ka paditur Bashkinë e Lezhës, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me objekt *“shfuqizimin e aktit administrativ, urdhër nr. 607, datë 20.08.2020 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare me znj. D.Ll”*” etj. Me Vendimin nr. 285, datë 22.04.2021, kjo gjykatë ka vendosur rrëzimin e padisë së ankueses.

Në vijim, znj. D.Ll ka aplikuar dhe ka konkuruar për procedurën e pranimit në shërbimit civil, mbështetur në shpalljen nr. 16192 prot., datë 08.09.2020, ku janë shpallur 4 pozicione vakante *“Specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujitjes, në njësinë Administrative Shënkoll, Shëngjin, Blinisht dhe Kallmet”*. Lloji i diplomës së kërkuar për këto pozicione pune ka qenë *“Shkenca Juridike/Agronomi, Niveli i Diplomës Master Bachelor”*. Znj. D.Ll ka marrë pjesë në testimin me shkrim, nga ku, në bazë të vlerësimit të Komitetit të Përhershëm të Pranimit nuk ka rezultuar fituese dhe si rrjedhim nuk është kualifikuar për fazën e intervistës së strukturuar. Ankuesja sqaron se për pozicionin e punës që ajo ka aplikuar është përzgjedhur një jurist, fakt që e konsideron jo të drejtë, pasi ai pozicion pune i takon dikujt që ka përfunduar studimet për Agronomi, dhe jo një juristi.

Për sa më sipër, Znj. D.Ll kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjes politike dhe gjendjes arsimore, si dhe kërkon rikthimin e saj në pozicionin e punës që ajo ka patur pranë Zyrës së Gjendjes Civile Blinisht, Lezhë, në vitet 2012 - 2015, duke arsyetuar se ajo ka konkuruar për atë pozicion pune dhe i takon rikthimi në këtë detyrë.

- Procedurat e ndjekura nga Komisioneri:

Pas analizimit paraprak të ankesës së znj. D.Ll, Komisioneri e njoftoi me e-mail për plotësim të saj me informacion. Informacioni konsistonte në përcaktimin e saktë të momentit të ndodhjes dhe konstatimit të diskriminimit të ndodhur, sipas periudhave kohore, përgjatë së cilave shtriheshin pretendimet e saj për diskriminim, që ishin përkatësisht përgjatë viteve 2012-2018 dhe përgjatë periudhës 2018 e në vijim.

Në përgjigje të e-mailit të KMD-së, ankuesja u përgjigj duke mos përcaktuar momentet e sipërcituara, por duke cilësuar në mënyrë të detajuar pretendimet e saj për diskriminim, nga momenti i largimit të saj në Gjermani në vitin 2015 e në vijim.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 94, datë 24.05.2021, e znj. D.LI, KMD konstatoi se:

Në ankesën nr. 94, datë 24.05.2021, e znj. D.LI. pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*” dhe “*gjendjes arsimore*”, nga ana e Bashkisë Lezhë.

Për sa më sipër, mbështetur në të dhënat e shënuara nga ankuesja në formularin e ankesës, si dhe ato të dërguara me e-mail rezulton se periudha që i përket diskriminimit të pretenduar nga ana e saj ka kohëzgjatje nga momenti, në të cilin ajo ka shkuar në Gjermani e në vijim. Në formularin e ankesës, është lënë e paplotësuar data, kur ka ndodhur diskriminimi i saj. Ndërkohë që, në formularin e ankesës, znj. D.LI është shprehur se ka marrë dijëni mbi diskriminimin e ushtruar ndaj saj në datën 10.03.2018. Sipas ankuses, ajo ka marrë dijëni mbi diskriminimin e ushtruar ndaj saj, në momentin, që është kthyer nga Gjermania dhe nuk është sistemuar në pozicionin e punës, që ajo ka mbajtur pranë Zyrës së Gjendjes Civile Blinisht, Lezhë (përgjatë viteve 2012-2015). Pikërisht në këtë pozicion, ajo kërkon rikthim me vendim të Komisionerit, me arsyetimin se ajo ka konkuruar për këtë pozicion pune dhe i takon të rikthehet në të.

Në nenin 33, pika 4, gërma dh), të LMD, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Ankesa nuk pranohet nëse: ...dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijëni për sjelljen diskriminuese*”. Referuar formularit të ankesës rezulton se ankuesja ka marrë dijëni mbi diskriminimin e pretenduar në datën **10.03.2018**, ndërkohë që ankesa e saj është depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në datën **24.05.2021**, pra me shumë se 3 vite më vonë, nga marrja dijëni mbi të.

Përveç sa më sipër, Komisioneri konstatoi se ankuesja pretendon diskriminim për bindjet e saj të djathta⁴, politike, përgjatë dy periudhave të ndryshme kohore, kur pozicioni i Kryetarit të Bashkisë Lezhë mbahej nga z. F. F., që ishte përfaqësues i subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë dhe aktualisht kur ky pozicion mbahet nga z. P. N., i cili është përfaqësues i forcës politike Partia Socialiste të Shqipërisë. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se shkak i diskriminimit është i pambështetur.

Edhe në lidhje me shkakun “*gjendja arsimore*”, që lidhet me pretendimin për diskriminim të ankuses, pasi nuk ka rezultuar fituese në konkurimin e kryer pranë Bashkisë Lezhë, por në vendin e saj ka fituar një jurist, ndërkohë që ajo mendon se në këtë pozicion pune duhej emëruar një agronom, Komisioneri gjykon se ky shkak është i pambështetur. Referuar akteve të depozituara në cilësi prove rezulton se lloji i diplomës së kërkuar për pozicionin e punës, ku ankuesja ka konkuruar ka qenë “*Shkenca Juridike/Agronomi...*”. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se mundësia e përzgjedhjes së një juristi, apo agronomi ka qenë e njëjtë, në varësi të

⁴ Referuar Vërtetimit të datës 30.04.2021, të lëshuar nga Kryetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Dega Lezhë, rezulton se ankuesja është anëtare e këtij subjekti politik.

rezultatit të konkurimit. Komisioneri sugjeron që lidhur me këtë çështje, ankuesja t'i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, nëse mendon se ka patur paligjshmëri gjatë zhvillimit të konkurimit.

Mbështetur në nenin 33, pika 4, gërma ç), të LMD, të ndryshuar, ku parashikohet: “Ankesa nuk pranohet nëse: ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, Komisioneri çmon se ankesa e znj. D.Ll. nuk pranohet pasi është haptazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 7, 12, 13, 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërmat ç) e dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 94, datë 24.05.2021, së znj. D.Ll., pasi ankesa e saj është depozituar tej afateve ligjore pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe është haptazi e pabazuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Robert GAJDA

KOMISIONER

Shkak - bindja politike, gjendja arsimore
Fusha – Punësim
Lloji i vendimit - mospranim